

Streptokoku i grupit B

Informacion për gratë shtatzëna

Kjo fletë informacioni synon të japë informacion në lidhje me streptokokun e grupit B – gjithashtu i njohur si 'streptokoku i grupit B' ose 'GBS'. Në këtë fletë informacioni ne do t'i referohemi atij si streptokoku i grupit B.

Kjo fletë informacioni shpjegon me hollësi se çfarë është streptokoku i grupit B dhe si mund të ndikojë ai në shtatzëninë dhe lindjen tuaj dhe ndaj vendimeve që merrni.

Pikat kryesore

- Streptokoku i grupit B është një nga bakteret e shumta që jetojnë normalisht në trupat tanë dhe që zakonisht nuk shkaktojnë dëm.
- Ekzaminimi për streptokokun e grupit B nuk ofrohet në mënyrë rutinë për të gjitha gratë shtatzëna në Mbretërinë e Bashkuar.
- Në rast se keni streptokokun e grupit B, në shumicën e rasteve fëmija juaj do të lindë i sigurt dhe nuk do të zhvillojë ndonjë infeksion.
- Megjithatë, rrallëherë mund të shkaktojë infeksione serioze si për shembull sepsis, pneumoni ose meningjit.
- Shumica e infeksioneve Streptokokale të grupit B me fillim të hershëm janë të parandalueshme.
- Në rast se streptokoku i grupit B gjendet në urinë, në vaginë ose rektum (zorrë) gjatë shtatzënisë tuaj aktuale, ose në rast se më parë keni pasur një fëmijë që është prekur nga infeksioni i streptokokut të grupit B, juve duhet t'ju ofrohet zgjedhja që të merrni antibiotikë gjatë lindjes për të reduktuar rrezikun e vogël të këtij infeksioni tek fëmija juaj.
- Në rast se keni qenë bartëse e streptokokut të grupit B gjatë shtatzënisë së mëparshme, juve do t'ju ofrohet mundësia e një testi gjatë kësaj shtatzënie dhe/ose antibiotikë gjatë lindjes.
- Rreziku që foshnja juaj të sëmuret për shkak të infeksioneve Streptokokale të grupit B rritet nëse foshnja juaj ka lindur para kohe, nëse keni temperaturë gjatë kohës së lindjes, ose nëse ujërat plasin para se të lindni.
- Nëse foshnja juaj e porsalindur zhvillon shenja të infeksioneve Streptokokale të grupit B, ato duhet të trajtohen menjëherë me antibiotikë.

Lindja juaj, zgjedhja juaj

Në rast se keni ndonjë pyetje apo shqetësim, ju lutemi flisni me mjekun ose maminë tuaj. Ne jemi këtu për t'ju mbështetur dhe për t'ju dhënë njohuri dhe informacion në mënyrë që të merrni një vendim dhe të bëni zgjedhjet më të mira për veten, foshnjën tuaj dhe familjen tuaj.

Për të mbështetur vendimmarrjen tuaj, ju mund të filloni duke na bërë tre pyetje:

- Cilat janë opsionet e mia?
- Cilat janë anët pozitive dhe negative në lidhje me secilën prej opsioneve për mua?
- Si mund të marr mbështetje për të më ndihmuar të marr vendimin e duhur për veten time?

Në rast se keni pyetje të tjera, ju lutem mos hezitoni të na pyesni. Ju mund ta gjeni të dobishme të shkruani çdo pyetje që mund të keni dhe t'i merrni ato me vete gjatë takimeve tuaja.

Hyrje

Streptokoku i grupit B është një lloj bakteri i pranishëm në zorrë dhe rrallë shkakton problem, jashtë shtatzënisë, tek të rriturit e shëndetshëm.

4 nga 10 gra mund të mbartin Streptokokun e grupit B pa patur simptoma.

Evidencat aktuale nuk mbështesin ofrimin e testimit rutinë për Streptokokun e grupit B gjatë shtatzënisë.

Në rast se jeni mbartëse e Streptokokut të grupit B dhe jeni shtatzënë, në shumicën e rasteve fëmija juaj do të lindë i sigurt dhe nuk do të zhvillojë ndonjë infektion. Megjithatë, rrallëherë, streptokoku i grupit B mund të shkaktojë infektion serioz tek një foshnjë, e cila njihet si sëmundja GBS e fillimit të hershëm tek të porsalindurit (EOGBS). Ky është një shkak i njohur i infeksionit të rëndë neonatal, i cili përfshin sepsis, pneumoninë apo meningjitin, në rreth 1-2% (1 në 500) lindje në MB dhe Irlandë. Në rast se kjo ndodh, zakonisht ndodh brenda shtatë ditëve të para të lindjes, por ndonjëherë mund të ndodhë më vonë.

Duke qenë se streptokoku i grupit B është një bakter i cili haset natyrshëm, një grua mund të kalojë nëpër fazat e të qenit dhe të mos qenit një bartëse e baktereve në vaginë gjatë shtatzënisë.

Po sikur të kem pasur streptokokun e grupit B gjatë shtatzënisë së mëparshme?

Në rast se keni pasur streptokokun e grupit B gjatë shtatzënisë së mëparshme, ekziston një mundësi prej 50% që ju do ta keni atë përsëri gjatë kësaj shtatzënie. Ju mund të zgjidhni të bëni një test për të parë nëse jeni ende bartëse dhe/ose mund të zgjidhni të merrni antibiotikë gjatë lindjes.

Si zbulohet streptokoku i grupit B ?

Ka disa mënyra se si mund të zbulohet:

- Ju tashmë mund ta dini që jeni bartëse e streptokokut të grupit B nga një shtatzëni e mëparshme ose keni pasur më parë një fëmijë të prekur nga EOGBS. Ekziston një mundësi 1 në 2 raste (50% mundësi) që të keni streptokokun e grupit B nëse keni rezultuar pozitive për të më parë. Megjithatë, ju mund të keni dëshirë të bëni përsëri testin për të gjatë kësaj shtatzënie, pasi ekziston gjithashtu një mundësi prej 50% që të mos rezultoni pozitive me streptokokun e grupit B.

- Ju mund të keni bërë një test urine ose një tampon vaginal gjatë shtatzënisë tuaj aktuale që tregon se jeni bartëse e streptokokut të grupit B.

Çfarë kuptimi mund të ketë streptokoku i grupit B për shtatzëninë dhe lindjen time?

Juve do t'ju ofrohet zgjedhja për të marrë antibiotikë gjatë lindjes në rast se:

- është gjetur streptokoku i grupit B në ndonjë nga shtatzënitë tuaja të mëparshme.
- foshnja juaj e mëparshme ka qenë i infektuar me sëmundjen e streptokokut të grupit B me fillim të hershëm ose me fillim të vonë
- mamia ose mjeku juaj ju informon se keni një infeksion të traktit urinar të shkaktuar nga streptokoku i grupit B ose rezultat pozitiv të tamponit vaginal dhe/ose rektal
- ju jeni një bartëse e streptokokut të grupit B dhe ujërat tuaja kanë plasur në afat (37+0 javë shtatzëni)
- lindja juaj ka filluar para 37 javësh, pavarësisht nëse jeni bartëse e streptokokut të grupit B apo jo.

Antibiotikët iu ofrohen të gjitha grave që janë testuar për streptokokut të grupit B dhe është zbuluar se janë bartëse të tij. Arsyeja për këtë është se, pavarësisht se vetëm një numër i vogël i foshnjave do të preken rëndë, nuk ka asnjë mënyrë që ne të dimë se cilat foshnja do të preken, dhe për këtë arsye duhet të ofrojmë zgjedhjen e përdorimit të antibiotikëve gjatë lindjes për të gjitha gratë që janë bartëse të bakterit.

Është e rëndësishme të theksohet se jo të gjitha foshnjat do të zhvillojnë infeksionin, për këtë arsye opsioni i antibiotikëve është një masë mbrojtëse.

Ju lutem vini re:

- Në rast se streptokoku i grupit B është konfirmuar nga tamponi vaginal, nuk është e nevojshme të merrni trajtim në kohën kur është zbuluar, dhe juve do t'ju ofrohet zgjedhja për marrjen e antibiotikëve gjatë lindjes.
- Megjithatë, në rast se është konfirmuar se keni një infeksion të traktit urinar të shkaktuar nga streptokoku i grupit B në një moment të shtatzënisë, ne do t'ju ofrojmë trajtim për këtë me antibiotikë dhe gjithashtu do t'ju ofrohet zgjedhja që të merrni antibiotikë gjatë lindjes.

Antibiotikët gjatë lindjes zakonisht nënkuptojnë një lindje në spital ose në pavijonin e lindjes ose në një repart përkrah njësisë së lindjes. Kjo bëhet për shkak të pajisjeve të nevojshme për serum me pika. Flisni me maminë ose mjekun tuaj nëse shpresoni të keni një lindje në shtëpi ose në një njësi lindjeje të pavarur siç është Qendra e Lindjes Edgware.

A mund të shkaktojnë ndonjë dëm antibiotikët që merren gjatë lindjes?

Disa gra mund të përjetojnë efekte anësore të përkohshme si për shembull nuk ndjehen mirë ose kanë diarre. Gratë mund të jenë alergjike ndaj antibiotikëve të caktuar dhe në raste të rralla, reagimi mund të jetë i rëndë dhe kërcënues për jetën (anafilaksi). Kjo është arsyeja pse ne nuk ofrojmë antibiotikë intravenozë në shtëpi ose në një qendër të pavarur të lindjes. Tregojini profesionistit të kujdesit shëndetësor në rast se e dini që jeni alergjike ndaj penicilinës ose ndonjë medikamenti tjetër.

Mamia ose mjeku juaj do të diskutojë me ju për anët pozitive dhe rreziqet e marrjes së antibiotikëve gjatë lindjes për të parandaluar infeksionin e shkaktuar nga streptokoku i grupit B me fillim të hershëm tek foshnja juaj.

Të gjitha foshnjat monitorohen pas lindjes. Në rast se ata janë në një rrezik në rritje të zhvillimit të infeksionit EOGBS, ata do të kontrollohen për (temperaturën, rrahjet e zemrës dhe frekuencën e frymëmarrjes) çdo orë gjatë dy orëve të para, dhe më pas çdo dy orë derisa fëmija të jetë 12 orësh.

Këto vëzhgime mund të kryhen në spital ose në një repart përkrah njësi së lindjes. Këto vëzhgime nuk mund të kryhen në shtëpi gjatë 12 orëve. Juve gjithashtu do t'ju jepet informacion në lidhje me shenjat e rëndësishme të cilave duhet t'i kushtoni vëmendje dhe informacioni në lidhje me këtë është përfshirë më poshtë (shih pjesën: 'Cilat janë shenjat e infeksionit të shkaktuara nga streptokoku i grupit B tek foshnja ime?').

A mund të ndikojë streptokoku i grupit B tek procesi i lindjes dhe tek lindja ime?

Gratë mund të jenë alergjike ndaj antibiotikëve të caktuar dhe në raste të rralla, reagimi mund të jetë i rëndë dhe kërcënues për jetën (anafilaksi). Kjo është arsyeja pse ne nuk ofrojmë antibiotikë intravenozë në shtëpi ose në një qendër të pavarur të lindjes.

Duke qenë se antibiotikët jepen në mënyrë intravenoze (nëpërmjet një tubi direkt në venën tuaj), ju duhet të jeni në një ambient spitalor, ose në një nga qendrat tona të lindjes ose në pavijonin tonë të lindjes, nëse vendosni të merrni antibiotikë gjatë lindjes. Në rast se keni streptokokun e grupit B dhe vendosni të merrni antibiotikë, ju përsëri mund të kryeni procesin e lindjes dhe të lindni në një pishinë për lindjet.

Në rast se jeni e shqetësuar për rezultatin tuaj të streptokokut të grupit B dhe se si do të ndikojë ai në vendin ku do të lindni foshnjën tuaj, mos hezitoni të flisni me maminë ose mjekun tuaj.

A ka ndonjë rast tjetër ku nëse jam bartëse e streptokokut të grupit B mund të ndikojë tek shtatzënia dhe lindja ime?

- Në rast se dëshironi, ju mund të keni ende një heqje (ose fshirje) të membranës ose ndonjë formë të nxitjes së lindjes në rast se jeni bartëse e streptokokut të grupit B.
- Në rast se jeni bartëse e njohur e streptokokut të grupit B dhe keni një lindje spontane ose të induktuar, do t'ju ofrohet antibiotik intravenoz (nëpërmjet pikave) gjatë gjithë punës për lindjen.
- Në rast se keni një lindje të parakohshme, do t'ju rekomandohet të merrni antibiotikë gjatë lindjes, pasi foshnja juaj mund të jetë i ekspozuar ndaj një rreziku më të lartë të infeksionit. Kjo sepse infeksioni është një nga shkaqet më të zakonshëm të lindjes së parakohshme, dhe streptokoku i grupit B është një nga bakteret më të zakonshme që lidhen me infeksionin.
- Në rast se ujërat tuaja do të plasim para javës së 37-të, nuk do të jetë e nevojshme që të kryeni test për streptokokun e grupit B. Megjithatë, do t'ju ofrohet zgjedhja të merrni antibiotikë sapo të fillojë puna e lindjes (në mënyrë të natyrshme ose për shkak të induksionit).

- Pas 37 javësh, në rast se ujërat tuaj kanë plasur për më shumë se 18 orë, do t'ju ofrohet trajtim me antibiotikë, pasi ky është një faktor rreziku për streptokokun e grupit B.
- Në rast se do t'i nënshtroheni një lindje të planifikuar cezariane në afat ose para kohe, kur nuk ju kanë filluar dhimbjet e lindjes dhe ujërat nuk kanë plasur, nuk kërkohet përdorimi i antibiotikëve për streptokokun e grupit B.

Është e rëndësishme të theksohet se në rast se vendosni për antibiotikë gjatë lindjes, rekomandohet që t'ju jepen të paktën 4 orë para lindjes, gjatë kohëzgjatjes së lindjes.

Çfarë do të ndodhë pas lindjes së foshnjës time, nëse kam marrë antibiotikë gjatë lindjes për shkak të streptokokut të grupit B?

Në rast se keni marrë antibiotikë të paktën katër orë para lindjes së foshnjës tuaj, nuk do të jetë e nevojshme që foshnja juaj të ketë ndonjë vëzhgim shtesë. Në rast se antibiotikët janë dhënë më pak se 4 orë para lindjes, pediatri (mjeku i foshnjës) mund të dëshirojë që fëmija juaj të ketë vëzhgime shtesë gjatë 12 orëve pas lindjes.

Cilat janë shenjat e infeksionit të shkaktuar nga streptokoku i grupit B tek foshnja im?

Shumica e foshnjave që zhvillojnë infeksionin e shkaktuar nga streptokoku i grupit B nuk ndihen mirë në javën e parë të jetës (e cila njihet si infeksion GBS i fillimit të hershëm), zakonisht brenda 12-24 orëve nga lindja. Megjithëse më pak e zakonshme, infeksioni i shkaktuar nga streptokoku i grupit B me fillim të vonshëm mund të prekë fëmijën tuaj deri sa të arrijë moshën tre muajshe. Marrja e antibiotikëve gjatë lindjes nuk parandalon shfaqjen e streptokokut të grupit B të fillimit të vonshëm.

Më shumë informacion mbi infeksionin e shkaktuar nga streptokoku i grupit B me fillim të vonshëm gjendet në adresën: www.gbss.org.uk/infection

Foshnjat me infeksionin e streptokokut të grupit B të fillimit të hershëm mund të shfaqin shenjat e mëposhtme:

- mërmëritje, frymëmarrje e zhurmshme, rënkim, duket se po mundohen shumë për të marrë frymë kur shikon gjoksin ose barkun e tyre, ose nuk marrin frymë fare
- janë shumë të përgjumur dhe/ose nuk reagojnë
- qajnë në mënyrë të pangushëllueshme
- janë të lëshuar në mënyrë të pazakontë
- nuk ushqen mirë ose nuk e mbajnë qumështin
- niveli i sheqerit në gjak është i ulët*
- kanë një temperaturë të lartë ose të ulët dhe / ose lëkura e tyre ndihet shumë e nxehtë ose e ftohtë
- kanë ndryshime në ngjyrën e lëkurës (përfshirë lëkurën me njolla)
- rrahja e zëmrës ose ritmi i frymëmarrjes është i shpejtë ose i ngadaltë në mënyrë jo normale
- kanë tension të ulët të gjakut *

* identifikuar nga testet e bëra në spital

Në rast se vëreni ndonjë nga këto shenja ose jeni e shqetësuar për foshnjën tuaj, duhet të kontaktoni urgjentisht profesionistin e kujdesit shëndetësor dhe gjithashtu të përmendni streptokokun e grupit B. Në rast se foshnja juaj ka infeksionin e shkaktuar nga streptokoku i grupit B, diagnoza dhe trajtimi i hershëm është i rëndësishëm pasi vonesa mund të jetë shumë serioze ose edhe fatale.

A mund ta ushqej me gji nëse kam streptokokun e grupit B?

Po. Streptokoku i grupit B nuk ka treguar të ketë ndonjë ndikim në qumështin e gjirit, dhe ushqyerja me gji ka shumë përfitime pozitive për ju dhe foshnjën tuaj.

Për mbështetjen mbi ushqimin me gji ju mund të vizitoni adresën:

www.royalfree.nhs.uk/services/services-a-z/maternity-services/feeding-your-baby

Kam ende pyetje, me kë mund të flas?

Në rast se keni pyetje të tjera në lidhje me streptokokun e grupit B gjatë shtatzënisë, ju lutemi flisni me maminë ose mjekun tuaj.

Informacione të mëtejshme

Për më tepër informacion rreth shërbimit të maternitetit në Royal Free London vizitoni faqen: www.royalfree.nhs.uk/maternity

Komentet tuaja në lidhje me këtë fletëpalosje

Në rast se keni ndonjë koment mbi këtë fletëpalosje ose për një listë të referencave të saj, ju lutem dërgoni email në adresën: rf.communications@nhs.net

Na tregoni për kujdesin tuaj

Nëse keni ndonjë koment në lidhje me kujdesin dhe / ose përvojën tuaj në Royal Free London ju lutemi dërgoni një email Kryetarit të Maternity Voices Partnership (MVP): royalfreematernityvoices@gmail.com

Mirënjohje

Përshtatur me lejen e Kolegjit Mbretëror të Obstetërve dhe Gjinekologëve nga: Kolegji Mbretëror i Obstetërve dhe Gjinekologëve. Fletëpalosja e informacionit për pacientin "Streptokoku i Grupit B (GBS) gjatë shtatzënisë dhe foshnjat e porsalindura", Londër: RCOG; Dhjetor 2017

Formatet Alternative

Gjithashtu kjo fletëpalosje gjendet në shkronja shtypi të mëdha dhe në disa gjuhë të tjera. Në rast se keni nevojë për këtë fletëpalosje në një format tjetër – për shembull Braille, një gjuhë tjetër përveç Anglishtes ose në audio - ju lutemi flisni me një nga anëtarët e personelit.

© Royal Free London NHS Foundation Trust

Shërbimi: Materniteti

Versioni numër: 1

Data e miratimit: Mars 2021

Data e rishikimit: Mars 2023

www.royalfree.nhs.uk

Royal Free London (Mar 2021) *Group B Streptococcus in pregnancy* Version 1. London:
RFL